

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Auditim
(zgjidhjet)**

P6

Data 26/01/2019

Detyra 1

Partneri i angazhimit në auditimin e Garazha Shpk ka kërkuar nga ju të filloni me planifikimin e auditimit. Kompania është klient i ri i firmës tuaj të auditimit.

Kompania ka një qarkullim prej €5 milion dhe fitim prej €300,000. Kompania ka një kontratë franshize për shitjen e automjeteve të njohura për regionin e Kosovës dhe operon nga Gjakova dhe Prishtina. Kompania gjithashtu shet edhe automjete të përdorura dhe ofron shërbime të riparimit/servisit për automjete dhe shitje të karburanteve.

Garazha Shpk është themeluar në vitin 1989 dhe është udhëhequr nga familja Gashi. Aktualisht kompania është duke u menaxhuar nga Ariani dhe Arta së bashku me kushëririn Ganiu. Ariani është përgjegjës për servisimin e automjeteve dhe shitjen e karburanteve. Ai është në këtë pozicion që 10 vite. Arta së voni është bërë përgjegjëse për administratën dhe kontabilitetin pas pensionimit të axhës së saj i cili ishte marr me këto punë. Më herët Arta ishte përgjegjëse për shitjen e automjeteve të reja dhe të përdorura. Ganiu i cili është djali i axhës së Artës ishte bashkangjitur kompanisë së voni dhe tani është përgjegjës për shitjen e automjeteve të reja dhe të përdorura.

Kompania ka shitur rreth 200 automjete të reja gjatë vitit dhe aktualisht i ka 20 automjete të reja në stoqe prej të cilave 15 janë porositur nga konsumatorët dhe 5 të tjera mbahen për qëllim të ekspozimit dhe për vozitje testuese. Gjithashtu në stoqe janë edhe 60 automjete të përdorura të cilat ishin pranuar si kompenzim nga konsumatorët nga shitja e automjeteve të reja. Kompania ka një sasi të madhe të stoqeve të pjesëve rezervë.

Kompania ka një nivel domethënës të huave afatshkurta të cilat i përdor për të blerë stoqe dhe për ndërtimin e shtesës së re të hapësirës ekspozuese në lokacionin e Prishtinës.

Nga artikujt e fundit të revistave të automjeteve mësohet se prodhuesi i automjeteve nga i cili furnizohet dhe ka franshizë Garazha Shpk është duke konsideruar zvogëlimin e gamës së llojeve të automjeteve të prodhuara. Gjithashtu është mësuar se ky prodhues është duke konsideruar që të merr përsipër shitjen direkte tek konsumatorët e fundit e jo përmes kompanive të distribuimit. Kjo mund të ndodhë edhe për shkak të legjislacionit të ri që është miratuar së voni.

Kërkohe:

(a) Vlerësoni rrezikun e vetëvetishëm në nivel të entitetit dhe në nivel të gjendjes së llogarive/klasëve të transaksioneve të kompanisë Garazha Shpk. (8 pikë)

(b) Përshkruani kontrollat e brendshme që duhet të ekzistojnë mbi shitjen e automjeteve nëse konsiderohet se rreziku i kontrollit mund të jetë i ulët në këtë fushë. (6 pikë)

(c) Rekomandoni punën e auditimit që duhet të kryhet për tu siguruar se kompania është duke operuar sipas hipotezës së vijimësisë. (6 pikë)

[Total: 20 Pikë]

Zgjidhja

(a) Rreziku i vetvetishëm

Në nivel të entiteti	Arsyetimi
1. Integriteti i drejtorëve dhe menaxherëve	Nuk është rrezik përveç përvojës së Ganiut i cili i ri në biznes. Nuk ka gjasa të mëdha për pandershmëri pasi që biznesi është familjar
2. Përvoja dhe njohuria e menaxhmentit	Riorganizimi i biznesit ka shkaktuar porblemde – mungesa e përvojës së Ganiut në shitje dhe e Artës në administratë dhe kontabilitet. Duhet të kem vëmendje të shtuar në të dy fushat, sidomos në vendimet e Ganiut lidhur me automjetet e përfutuara si kompenzim
3. Presion i pazakont i drejtorëve ose menaxhmentit	Huatë afatshkurta mund të vendosin presion mbi menaxhmentin për të prodhuar rezultate më të mira se sa aktualet, me qëllim të përmbushjes së kushteve të kredive nga banka
4. Natyra e biznesit të kompanisë	Vështirësia kryesore është me stoqet e automjeteve të përdorura – vlera neto e realizueshme e tyre. Biznesi konkurrues mund të shkaktoj edhe praktika të pandershme që mund të rezultojnë me detyrime kontingjente dhe pretendime gjyqësore psh nga servimi i dobët i automjeteve.
5. Faktorët e industrisë	Qarkullimi i mirë i automjeteve të reja mund të shkaktoj ngecje në shitjen e automjeteve të përdorura – vlera neto e realizueshme e tyre Hyrja në treg e ofruesit të franshizës Mund të rritet numri i stoqeve të pjesëve rezervë nga modelet e automjeteve që ndërpriten nga prodhimi

Në nivel të gjendjeve të llogarive dhe klasëve të transaksioneve	Arsyetimi
1. Llogaritë që mund të jenë të ndjeshme ndaj anomalive ose gabimeve	Vlerësimi i automjeteve të përdorura Vlerësimi i pjesëve rezervë
2. Transaksione komplekse	Nuk ka përveç kompenzimeve të llogaritura
3. Shkalla e përdorimit të gjykimit në përcaktimin e gjendjeve të llogarive	Vlerësimi i automjeteve të përdorura dhe pjesëve rezervë Zhvlerësimi i pasurive joqarkulluese
4. Ndjeshmëria ndaj humbjes ose mashtrimit	Nuk ka gjasë të madhe të ndodhjes përveç nëse nuk janë siguruar si duhet

5. Cilësia e sistemeve të kontabilitetit	Mund të jetë e ndjeshme për shkak të riorganizimit të menaxhmentit të kompanisë
6. Transaksione të pazakonta në fund të vitit	Nuk ka

(b) Kontrollat e brendshme mbi shitjen e automjeteve

1. Nëse me para të gatshme, kontrollat mbi paratë, ndarja e detyrave; nëse me kredi, verifikimi i aftësisë së pagesës së konsumatorëve
2. Vlera e kompenzimeve të kontrollohet dhe diskutohet nga personeli me përvojë të duhur
3. Monitorim i rregullt i moshës së automjeteve të marra me kompenzim për të siguruar se vlera e tyre nuk është dëmtuar
4. Kontrollat fiziket mbi stoqet: çelësat e automjeteve të ruhen në arkë të mbyllur, automjetet të ruhen në hapësirë që mbyllet dhe të rrethuar.

(6 marks)

(c) Puna e auditimit lidhur me hipotezën e vijimësisë

Në fazën e planifikimit dhe nëse ekzistojnë ngjarje që mund të hedhin dyshim mbi hipotezën e vijimësisë së kompanisë, atëherë:

Kërkoni nga menaxhmenti të bëjnë vlerësimin e tyre të hipotezës së vijimësisë.

Duhet të vlerësohet mjaftueshmëria e procedurave të menaxhmentit në vlerësimin e hipotezës së vijimësisë dhe të bëhen shpalosjet e duhura në pasqyrat financiare duke:

1. Intervistuar drejtorët për opinionin e tyre për kërcënimet dhe si adresohen ato;
2. Rishikimi i informative financiare, psh buxhetet dhe parashikimet;
3. Planifikimi i procedurave për të identifikuar kërcënimet ndaj hipotezës së vijimësisë në një të ardhme të parashikueshme;

Kur vlerësohet vlerësimi i menaxhmentit për hipotezën e vijimësisë, konsideroni:

1. Procesin që ka ndjekur menaxhmenti në vlerësimin e tyre;
2. Supozimet e bëra nga menaxhmenti në vlerësimin e tyre;
3. Planet në të ardhme të menaxhmentit
4. A është përdorur e gjithë informata që auditorët janë në dijeni për të bërë vlerësimin
5. E ardhmja e parashikueshme - a është së paku 12 muaj nga përfundimi i vitit;
6. A ka system i cili mund të alarmojë për rreziqet në të ardhmen
7. Arsyeshmëria e supozimeve kyçe të përdorura në buxhete dhe parashikime të parasë;
8. Ndjeshmëria e buxheteve dhe parashikimeve
9. Ekzistenca, mjaftueshmëria dhe kushtet e kredisë nga furnitorët ose nga bankat
10. Planet e menaxhmentit të merren me çfardo kërcënim ose rreziku.

Detyra 2

(a) SNA 300 *Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare* kërkon që auditorët të përcaktojnë strategjinë e përgjithshme të auditimit.

Kërkohet:

Cilat elemente kryesore duhet të përfshihen në dokumentin e strategjisë së auditimit, dhe pse? (6 pikë)

(b) SNA 315 *Identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve të anomalive materiale përmes njohjes së entitetit dhe mjedisit të tij*, kërkon nga auditorët të vlerësojnë rreziqet e anomalive materiale qoftë nga mashtrimet ose gabimet, përmes përfundimit të njohurisë së entitetit dhe mjedisit të tij, përfshirë kontrollet e brendshme në mënyrë që të dizjanohen dhe kryhen procedurat e auditimit.

Kërkohet:

Vlerësoni në mënyrë kritike tre procedura të cilat duhet të kryhen nga auditorët për të përfunduar njohuri mbi entitetin për të kryer auditimin për herë të parë. (8 pikë)

(c) Në pajtueshmëri me SNA 320 *Materialiteti në planifikimin dhe kryerjen e auditimit*, diskutoni kuptimin e materialitetit dhe vlerësoni ndikimin që ka në auditim. (6 pikë)

[Total: 20 Pikë]

Zgjidhja

(a) Dokumenti i strategjisë së auditimit dhe plani i auditimit

Çështjet në vijim duhet të përfshihen në dokumentin e strategjisë së auditimit:

- Materialiteti i llogaritur
- Fushat e identifikuar me rrezik
- Datat dhe afatet kyçe, siç janë takimet me drejtorët, aksionarët, etj
- Kërkesat specifike për raportim, sidomos nëse kërkohet ndonjë raport shtesë përveç raporti i auditorit
- Lokacionet e entitetit dhe në cilat vende do të marrë pjesë auditori në numërimin e stokeve
- Qasja e planifikuar e auditimit, përfshirë:
 - Në çfarë mase do të mbështetemi mbi kontrole
 - Në çfarë mase do të mbështetemi në auditimin e brendshëm (nëse ka)
 - Në çfarë mase do të mbështetemi në punën e ekspertëve
- Zhvillimet specifike në industrinë e klientit që kanë ndikim mbi auditimin

(b) Procedurat

Auditorët duhet të:

- (i) Bisedojnë me menaxhmentin dhe personat e ngarkuar me qeverisjen për entitetin për të përftuar njohur se si operon biznesi si dhe cilat janë rreziqet kryesore të biznesit dhe ndryshimet në biznes gjatë vitit që auditohet.
- (ii) Vizitat në entitet për të vëzhguar llojet e pasurive që posedon entiteti dhe sistemet e vendosura. Kjo do të ndihmojë të ndërtohet një njohuri mbi llojet e gjendjeve të llogarive që mund të ekzistojnë në pasqyrat financiare.
- (iii) Përftimi pasqyrave financiare apo atyre menaxheriale
Kryerja e procedurave analitike në pasqyrat financiare aktuale dhe të mëparshme për të identifikuar fushat me rrezik në mënyrë auditimi të fokusohet në ato fusha me rrezik.
- (iv) Përftimi i buxheteve për vitin që auditohet dhe krahasimi me pasqyrat financiare për të identifikuar fusha me rrezik dhe diskutimi i variancave kryesore.
- (v) Rishikimi i manualëve të sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe vlerësimi nëse ato janë në gjendje të parandalojnë dhe zbulojnë dhe korrigjojnë gabimin. Nëse po, duhet të kryhen teste të kontrollit. evieë any internal control systems manuals and assess ehether they are capable of preventing or detecting and correcting errors.

(c) Materialiteti

Anomalitë ose mungesat mund të konsiderohen material individualisht ose të grupuara nëse mund të pritet me arsye të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të pasqyrave financiare. Materialiteti varet nga madhësia e gabimit e gjykuar në rrethana të caktuara. Materialiteti duhet të rishikohet edhe nga aspekti cilësor.

Ndikimi i materialitetit në auditim:

- Ndihmon auditorët në përcaktimin se cilat zëra duhet të testohen, pasi që zërat material duhet ti nënshtrohen procedurave thelbësore
- Ndihmon auditorët në përcaktimn nëse duhet të përdoret mostrimi
- Ndihmon auditorët të përcaktojnë se cilat anomalitë mund të rezultojnë me rezervim të opinionit

Materialiteti duhet të llogaritet në fazën e planifikimit

- Materialiteti i planifikuar duhet të rivlerësohet gjatë auditimit, nëse është e nevojshme
- Auditorët duhet të konsiderojnë faktin se cilët faktorë ndikojnë në zëra që të jenë material përveç vlerës së tyre
- Auditorët duhet të shënojnë anomalitë dhe të vlerësojnë a janë ato material nëse grupohen

Detyra 3

(a) Lidhur me konfirmimin e llogarive të arkëtueshme, shpjegoni çka nënkuptohet me:

(i) Konfirmimi pozitiv?

(ii) Konfirmimi negativ? (4 pikë)

(b) Lidhur me konfirmimin e llogarive të arkëtueshme, identifikoni tre lloje të të arkëtueshmeve që kërkohet konsiderim i veçantë. (3 pikë)

(c) Kresha Shk prodhon mobile për zyre dhe është klient i firmës tuaj tash disa vite. Firma juaj është duke planifikuar auditimin e pasqyrave të kësaj kompanie për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2018.

Në emailin e dërguar nga kompania, drejtori menaxhues ka deklaruar se kompania nuk mund të jetë në gjendje të ofroj personel për të mbikqyrur numërimin e stoqeve, pasi që ka mungesë të personelit me përvojë në numërimin e stoqeve.

Duke pasur parasysh njohurinë që ka firma e auditimit për kompaninë, ai ka kërkuar që firma e auditimit të ofroj personel për të mbikqyrur numërimin e stoqeve. Ai ka ofruar të paguaj shtesë për këtë shërbim dhe konsideron se ja vlen pasi që drejtorët e Kresha Shpk nuk do të ishin përgjegjës për saktësinë e numërimit të stoqeve, si bazë për vlerën e stoqeve të prezentuara në fund të vitit në pasqyrat financiare.

Kërkohet:

(i) Diskutoni qëllimin e pjesëmarrjes së auditorëve në numërimin e stoqeve në fund të vitit nga klienti. (4 pikë)

(ii) Vlerësoni se si partneri i angazhimit të firmës tuaj duhet t'i përgjigjet kërkesës nga drejtori menaxhues i kompanisë për të ofruar personel nga firma e auditimit për mbikqyrjen e numërimit të stoqeve. (5 pikë)

(iii) Përshkruani dy procedurat të auditimit lidhur me stoqet të cilat duhet të kryhen nga ekipi i auditimit pas pjesëmarrjes në numërimin e stoqeve. (4 pikë)

[Total: 20 Pikë]

Zgjidhja

(a)

(i) Konfirmimi pozitiv – nga konsumatorët kërkohet të konfirmojnë gjendjen e llogarisë direkt te auditorët për vlerën e paraqitur në fletëkonfirmim. Nëse nuk pajtohen me atë gjendje, ata kërkohet të tregojnë gjendjen sipas shënimeve të tyre.

(ii) Konfirmimi negativ – Nga konsumatorët kërkohet të konfirmojnë direkt te auditorët vetëm nëse nuk pajtohen me vlerën e paraqitur në fletëkonfirmim.

(b) Klasët e llogarive në vijim kërkohet të përfshihen në mostrën e konfirmimeve:

- Llogari të fjetura
- Llogari me saldo materiale
- Llogari me saldo zero
- Me balansa kreditore
- Me balansa të moshuara
- Që janë shlyer me llogari të pagueshme
- Me korrigjime domethënëse në librin kryesor
- Të paguara me shuma të rrumbullaksuara
- Që kanë kredit nota në fund të periudhës kontabël
- Që janë shlyer
- Që janë paguar deri në datën e konfirmimit

(c)

(i) Qëllimi i pjesëmarrjes së auditorit në numërimin fizik të stokeve është të vlerësohet efektiviteti i procedurave të klientit në numërimin e stokeve për të përcaktuar nëse mund të mbështetemi në ato procedura për të siguruar se ekzistencën dhe kushtet e stokeve.

(ii) Partneri i angazhimit duhet ti përgjigjet me edukatë për ti shpjeguar se nuk mund të ofroj personel për të mbikqyrur numërimin e stokeve. Shpjegimi i tij duhet ti referohet faktit se përgjegjësia për përmbajtjen dhe saktësinë e pasqyrave financiare është e menaxhmentit dhe kjo përgjegjësi nuk mund të delegohet.

Ai gjithashtu duhet duhet konfirmoj faktin se është detyrë e auditorit të përgatis raportin e auditimit i cili i adresohet aksionarëve të kompanisë lidhur me prezentimin e drejtë dhe të sinqert të pasqyrave financiare.

Nëse auditoët përfshihen në mbikqyrjen e numërimit të stokeve do të përbënte kërcënim të pavarësisë për shkak të vetë-rishikimit.

(iii) Anëtarët e ekipit të auditimit duhet të kryejnë procedurat në vijim:

Të kontrollohen nëse të gjitha fletënumërimet janë përfshirë në listat e numërimit

Gjurmohen numërimet testuese për tu siguruar se sasi të përfshira në fletënumërimet dhe lista janë të sakta.

Sigurohuni se stoqet që lëvizin ngadal dhe të dëmtuara jëna shënuar si duhet në fletënumërimet për tu regjistruar në procesin e vlerësimit.

Konfirmimi se procedurat e prerjes janë zbatuar si duhet duke kontrolluar një mostër të fletëdërgesave dhe fletëpranimeve në fund të vitit.

Konfirmohen llogaritjet e kostos për stoqet dhe punën në procs. Kjo përfshin verifikimin e regjistrave të kostos, faturave të blerjes dhe kostove të punës së ngarkuar në produkte. Vëmendje e veçantë për shpenzimet e përgjithshme të prodhimit të shpërndara në produkte.

Konfirmimi i vlerës neto të realizueshme duke kontrolluar për mallrat që janë shitur menjëherë pas datës së raportimit dhe çmimin e tyre.

Kryerja e procedurave analitike në stoqe për të përfutur siguri për plotësinë, saktësinë dhe vlerësimin.

Sigurohuni për mjaftueshmërinë e prezentimit dhe shpalosjeve në pasqyrat financiare për stoqet. Verifikoni përgjigjet nga entitetet që mbajnë stoqe në konsignacion për kompaninë.

Detyra 4

(a) SNA 560 – Ngjarjet pasuese ofron udhëzime për ngjarjet pasuese lidhur me pasqyrat financiare.

Kërkohet:

- (i) Shpjegoni dy llojet e ngjarjeve pasuese, duke ofruar shembuj të dy llojeve, dhe (5 pikë)
- (ii) Shpjegoni marrëdhënien në mes të hipotezës së vijimësisë dhe llojit të ngjarjes pasuese. (3 pikë)

(b) Njëri nga klientët tuaj Habibi Shpk ka vitin financiar që përfundon me 31 dhjetor 2018. Pasqyrat financiare pritet të miratohen me 18 shkurt 2019. Në vijim janë paraqitur ngjarjet që kërkojnë vëmendjen tuaj:

1. Me 2 janar 2019, Habibi ka shitur stoqe me çmim që është nën kosto (këto stoqe janë regjistruar në pasqyrat financiare të vitit deri me 31 dhjetor 2018 si stoqe përfundimtare).
2. Habibi ka emetuar aksione të reja me 3 janar 2019.
3. Një zjarr në depon e Habibi me 8 janar 2019 kishte shkatërruar të gjitha stoqet e kompanisë.
4. Një konsumator që i kishte borxh Habibit €150,000 me 31 dhjetor 2018 kishte falimentuar me 10 janar 2019.
5. Habibi kishte blerë një pasuri prej €80,000 me 21 janar 2019.
6. Me 27 janar 2019, avokatët e Habibi pranuan një pretendim nga një i punësuar i cili u rëzua në objektet e kompanisë me 1 gusht 2018. Avokatët vlerësuan vlerën e pretendimit së bashku me tarifat ligjore në vlerë prej €1 milion.

Kërkohet:

Rishikoni secilën nga ngjarjet më sipër dhe këshilloni duke asyretuar:

- Nëse është ngjarje korrigjuese apo jokorrigjuese, dhe
- Ndikimin e mundshëm në pasqyrat financiare të Habibi për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2018. (12 pikë)

[Total: 20 Pikë]

Zgjidhja

(a)

(i) Auditori duhet të kryej procedura për të përfutur dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit për të gjitha ngjarjet që ndodhin në mes të datës së pasqyrave financiare dhe datës së raportit të auditorit të cilat kërkojnë korrigjim ose shpallje në pasqyrat financiare.

Janë dy ngjarje pasuese – Korrigjuese dhe Jokorrigjuese.

Korrigjuese – ngjarjet që ofrojnë dëshmi shtesë lidhur me kushtet që kanë ekzistuar në datën e raportimit kërkojnë korrigjim të pasqyrave financiare.

Shembuj:

- Llogaritë e arkëtueshme që bëhen të pambledhshme
- Notat e kreditit për shitjet që janë kryer para datës së raportimit
- Stoqet që kanë ekzistuar në fund të vitit janë shitur pas fundit të vitit me çmim më të ulët se kosto.

Jokorrigjuese – ngjarjet lidhur me kushtet që janë paraqitur pas datës së raportimit por të cilat janë aq material të cilat kërkojnë shpallje në pasqyrat financiare për të siguruar se ato nuk janë çorientuese.

Shembuj

- Blerja e entitetit
- Çështjet gjyqësore pas datës së raportimit
- Ndonjë zjarr ose katastrofë natyrore ose të ngjashme

(ii) Nëse ndonjë ngjarje jokorrigjuese ndikon në hipotezën e vijimësisë, ngjarja bëhet korigjuese pasi që hipoteza e vijimësisë nuk mbetet e përshtatshme në përgatitjen e pasqyrave financiare ose nevojitet të përfshihen shpalosje të reja.

Shembull, nëse një ngjarje jokorrigjuese është një vërshim ose zjarr i cili ka shkatërruar objektet dhe stoqet e entitetit, kompania mund të mos jetë në gjendje të zëvendësoj fabrikën dhe stoqet prandaj duhet përgatitur pasqyrat në bazën e falimentimit.

(b)

1. Korigjuese: këto janë dëshmi të reja për kushtet që kanë ekzistuar para datës së raportimit – stoqet duhet të sjellen në vlerën netor të realizueshme.

2. Jokorrigjuese: ngjarja nuk ka ekzistuar para fundit të vitit – kërkohet shpalosje në pasqyrat financiare

3. Jokorrigjuese: stoqet janë shkatërruar pas fundit të vitit – shpalosje varësisht prej materilitetit

4. Korigjuese: saldoja e këtyre llogarive ka ekzistuar para fundit të vitit dhe ngjarja në ofron dëshmi shtesë – të shlyhen €150,000 si borxh i keq.

5. Jokorrigjuese: ngjarja ka ndodhur pas datës së raportimit – nuk ka nevojë për asnjë veprim

6. Korigjuese: ngjarja ka ndodhur para fundit të vitit, tani kemi dëshmit të reja – duhet të njihet një provision në pasqyrat financiare

Detyra 5

(a) SNA 510 Angazhimet Fillestare të Auditimit – Gjendjet Fillestare kërkon nga auditorët të kryejnë procedura shtesë të auditimit për të konfirmuar gjendjet fillestare për një angazhim të ri të auditimit. Përveç kësaj, SNA ofron udhëzime për ndikimin që kanë këto në raportin e auditorit nëse auditorët nuk janë në gjendje të konfirmojnë gjendjet fillestare ose nëse ato gjendje përmbajnë anomali.

Kërkohet:

(i) Përshkruani procedurat të cilat duhet të kryhen nga auditori për të konfirmuar gjendjet fillestare për një angazhim të ri të auditimit; dhe
(ii) Shpjegoni ndikimin në raportin e auditorit nëse auditorët nuk janë në gjendje të konfirmojnë gjendjet fillestare ose nëse ato gjendje përmbajnë anomali. (5 pikë)

(b) Shpjegoni cili është qëllimi i paragrafit të 'theksimit të çështjes' dhe ku duhet të vendoset ky paragraf në raportin e auditorit; (5 Pikë)

Ju jeni menaxher i auditimit në auditimin e kompanisë Speci Shpk. Senori i auditimit ka përgatitur disa ekstrakte të raportit draft të auditimit.

Përgjegjësia e auditorit

- (1) Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi të gjitha faqet e pasqyrave financiare bazur në auditimin tonë. Ne kemi kryer auditimin në pajtueshmëri me shumicën e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit
- (2) Këto standarde kërkojnë që ne të jemi në pajtueshmëri me kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe kryejmë auditimin për të përftuar siguri maksimale nëse pasqyrat financiare janë të pastra nga të gjitha anomali të qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit.
- (3) Ne kemi përgjegjësi të parandalojmë dhe zbulojmë mashtrimin dhe gabimin dhe të përgatisim pasqyrat financiare në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.
- (4) Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të përftuar dëshmi për shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga disponueshmëria dhe përvoja e anëtarëve të ekipit të auditimit. Ne kemi konsideruar kontrollet e brendshme relevante për entitetin dhe shprehim opinion mbi efektivitetin e këtyre kontrolleve.
- (5) Ne nuk e kemi vlerësuar paraqitjen e përgjithshme të pasqyrave financiare pasi që kjo është përgjegjësi e menaxhmentit. Ne kemi konsideruar arsyeshmërinë e vlerësimeve të reja kontabël të bëra nga menaxhmenti. Ne nuk kemi konsideruar përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit pasi që ato janë të njëjtat sikur vitin e kaluar. Në mënyrë që të konfirmojmë sasinë e stokeve të lëndës së parë, ne jemi mbështetur në punën e një eksperti të pavarur.

Ekstraktet janë me numra për të ju ndihmuar t'i referoheni në përgjigjen tuaj.

Kërkohet:

(b) Për ekstraktet e mësipërme të raportit të auditimit, identifikoni dhe shpjegoni PESË elemente të këtij raportin të cilat duhet të ndryshohen. Nuk kërkohet ti rishkruani ekstraktet e sakta. (10 pikë)

[Total: 20 Pikë]

Zgjidhja

(a)

Gjendjet fillestare

Nga auditori kërkohet të përftojë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme nëse gjendjet fillestare (të çeljes) përmbajnë anomali të cilat mund të ndikojnë në pasqyrat financiare dhe nëse politikat e kontabilitetit janë zbatuar në mënyrë konsistente nga viti në vit.

(i) Auditori duhet të kryejë procedurat në vijim:

- Rishikimi i pasqyrave më të fundit financiare dhe raportin e auditimit të vitit të kaluar për informata relevante për gjendjet fillestare, përfshirë shpalosjet.
- Auditori do të përputh gjendjet fillestare me gjendjet përfundimtare të vitit të kaluar për të konfirmuar se janë bartur si duhet.
- Ata duhet të përcaktojnë nëse gjendje fillestare reflektojnë aplikimin e duhur të politikave të kontabilitetit.
- Ata duhet të konsiderojnë rishikimin e letrave të punës së auditorit të vitit të kaluar për të përfutur dëshmi lidhur me gjendjet fillestare.
- Nëse kjo nuk është e mundur, ata duhet të konsiderojnë nëse procedurat e kryera këtë vit ofrojnë dëshmi lidhur me gjendjet fillestare.
- Në raste të veçanta auditori duhet të kryejë procedura specifike të auditimit për të përfutur dëshmi lidhur me gjendjet fillestare.

(ii) Ndikimi në raportin e auditimit

Nëse auditori nuk është në gjendje të konfirmojë gjendjet fillestare, nga ata kërkohet të japin një opinion me rezervë ose mohim të opinionit për shkak të pamundësisë së grumbullimit të dëshmive të mjaftueshme dhe të përshtatshme. Nëse gjendjet fillestare përmbajnë anomali material, auditori duhet të jap opinion me rezervë ose kundër.

(b) Paragrafi i theksimit të çështjet tregon për një çështje që ndikon në pasqyrat financiare dhe i tërheq lexuesit të pasqyrave financiare tek shënimi i cili shpjegon më tutje çështjen. Theksimi i çështjes nuk përbën rezervim të opinionit. Zakonisht vendoset pas paragrafit të opinionit dhe tregon se opinion nuk është rezervuar për atë çështje.

Ky paragraf përdoret në rastet kur ka pasiguri material për hipotezën e vijimësisë e cila është shpalosur plotësisht në shënimet e pasqyrave financiare dhe rezultati i çështjes varet nga ngjarjet që do të ndodhin në të ardhmen.

(c) Elementet e raportit të auditorit

Ekstrakti 1

'Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi të gjitha faqet e pasqyrave financiare'. Kjo nuk është plotë pasi që nga auditori kërkohet të listojë të gjithë përbërësit e pasqyrave financiare që janë audituar, e që janë; pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e të ardhurave, pasqyra e ndryshimeve në ekuitet, pasqyra e rrjedhës së parasë, pasqyra e politikave kontabël dhe informatat shpjeguese. "Ne kemi kryer auditimin në pajtueshmëri me shumicën e SNA'. Nga auditori kërkohet të kryej auditimin me të gjitha SNA dhe nuk mund të zgjedhin vetëm disa standarde për të zbatuar.

Ekstrakti 2

'Përftojme siguri maksimale nëse pasqyrat financiare janë të lira nga të gjitha anomali'. Auditori nuk është në gjendje të përftojë siguri maksimale dhe ata nuk mund të konfirmojnë se pasqyrat financiare nuk përmbajnë anomali. Kjo për faktin se ata nuk i testojnë të gjitha transaksionet pasi që janë të fokusuar në saldo material. Prandaj auditorët japin vetëm siguri të arsyeshme.

Ekstrakti 3

'Ne kemi përgjegjësi të parandalojmë mashtrimin dhe gabimin'. Kjo nuk është e saktë pasi që është përgjegjësi e menaxhmentit e jo e auditorit të prandaojë dhe zbulojë mashtrimin dhe gabimin. Auditori ka vetëm përgjegjësi të zbulojë anomalitë material që mund të shkaktohen nga mashtrimet ose gabimet. 'Ne përgatisim pasqyrat financiare'. Edhe kjo është përgjegjësi e menaxhmentit pasi që ata i përgatisin pasqyrat financiare. Auditori jap një opinion me paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare.

Ekstrakti 4

'Procedurat e përzgjedhura varen nga disponueshmëria e personelit dhe përvoja e tyre'. Nga auditori kërkohet të përftojë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme prandaj ata duhet të kryejnë procedurat e nevojshme. Disponueshmëria dhe përvoja e anëtarëve të ekipit nuk duhet të diktojë nivelin e testeve të kryera.

'Ne japim një opinion mbi efektivitetin e këtyre kontrolleve të brendshme'. Raporti i auditimit përgatitet për aksionarët e kompanisë dhe auditori ofron një opinion për paraqitjen e drejtë dhe të sinqert të pasqyrave financiare. Firma e auditimit duhet të rishikojë efektivitetin e kontrolleve të brendshme dhe do të raportojnë për mangësitë kyçe të identifikuara gjatë auditimit.

Ekstrakti 5

'Ne nuk kemi vlerësuar paraqitjen e përgjithshme të pasqyrave financiare pasi që kjo është përgjegjësi e menaxhmentit'. Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare dhe prandaj ata do të rishikojnë nëse paraqitja e përgjithshme është e saktë. Mirëpo auditori është përgjegjës që të rishikojë paraqitjen e përgjithshme të pasqyrave financiare për të verifikuar nëse janë në pajtueshmëri me standardet e kontabilitetit dhe me punën e kryer nga auditori.

'Ne kemi konsideruar arsyeshmërinë e vlerësimeve të reja të kontabilitetit.' Nga auditori kërkohet të konsiderojë të gjitha vlerësimet kontabël të bëra nga menaxhmenti, nëse janë bartur nga vitet e mëparshme apo janë të reja. Vlerësimet nga vitet e mëparshme, siç janë provizionet, duhet të konsiderohen çdo vit pasi që ato mund të kërkohet të ndryshohen ose mund të mos kërkohen fare këtë vit.

'Ne nuk kemi rishikuar përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit pasi që janë të njëjtat nga viti i kaluar'. Politikat e kontabilitetit duhet të rishikohen çdo vit pasi që ato mund të ndryshohen në rrethana të kompanisë. Është e rëndësishme të rishikohet the appropriateness of accounting policies as these are the same as last year.'

'Ne jemi mbështetur në punën e kryer nga eksperti i pavarur'. Nga auditorët nuk pritet të kenë njohuri në të gjitha elementet e kompanisë prandaj është e pranueshme të mbështeten në punën e ekspertëve të jashtëm. Mirëpo, nuk është e pranueshme nga firma e auditimit t'i referohet këti fakti në raportin e auditorit pasi që kjo nënkupton se janë duke e bartur përgjegjësinë për këtë gjendje të llogarisë tek një palë e tretë. Auditori ka përgjegjësinë përfundimtare për opinionin e këshuar prandaj nuk mund ti referohet mbështetjes tek një palë e tretë në raportin e auditorit.